



INTERESI DHE FAKTORET QE NDIKOJNE NE NORMAT E INTERESIT

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT

INTERESI DHE FAKTORET QE NDIKOJNE NE NORMAT E INTERESIT

METODA E LLOGARITJES SË NORMËS EFEKTIVE TË INTERESIT

FONDI BESA sh.a

- Çmimi i huamarrjes:** Për të kuptuar forcat ekonomike që ndikojnë në luhatjen e normave të interesit, duhet fillimisht të japim një përkufizim të tyre. Norma e interesit është një çmim, dhe si çdo çmim tjetër ajo lidhet me një shkëmbim ose transfertë të një malli apo shërbimi ndërmjet një blerësi dhe një shitësi. Ky lloj i veçantë shkëmbimi është një hua ose kredi, e cila përfshin një huadhënës dhe një huamarrës. Në rastin e një kredie, huamarrësi merr një shumë parash për t'i përdorur për një periudhë kohe të caktuar, ndërsa huadhënësi merr premtimin e huamarrësit se këtë borxh do ta shlyejë në të ardhmen. Huamarrësi ka përparësinë e përdorimit të menjëhershëm të fondeve që merr, ndërsa huadhënësi i dorëzon këto fonde duke hequr përkohësisht dorë nga përdorimi i tyre. Për shkak se këta huadhënës sakrifikojnë përdorimin e menjëhershëm të fondeve, ata kërkojnë një kompensim shtesë përveç shumës së parave të dhëna borxh. Ky kompensim quhet interes ose ndryshe, çmimi që një huamarrës paguan për vënien në përdorim të fondeve të huadhënësit. E shprehur më thjesht, normat e interesit janë çmimi i huamarrjes.
- Llojet e normave të interesit:** Normat nominale të interesit përcaktohen në kontrata midis palëve të interesuara. Shumë norma interesi vendosen duke patur parasysh faktin se çdo negociatë mund të sjellë një normë specifike interesi. Kështu për shembull, përveç kredive bankare, një normë interesi me rëndësi të veçantë për ekonominë është interesi i paguar për bonot e thesarit. Në mënyrë të ngjashme edhe kompanitë private, publike apo shtetërore emetojnë letra me vlerë, duke përcaktuar norma nominale interesi të tjera. Individët përfitojnë interesa nga llogaritë e tyre bankare, të cilët zakonisht janë më të lartë në rastet kur paratë bllokohen për një periudhë kohe (llogari kursimi apo depozita) dhe më të ulëta kur mbahen në llogari rrjedhëse. Nga ana tjetër, individët paguajnë interes kur marrin hua për qëllime konsumi.
- Faktorët që ndikojnë në normat e interesit:** Ndryshimet në normat e interesit kanë të bëjnë si me faktorë të brendshëm të tregjeve financiare, ashtu edhe me faktorë jashtë tyre. Është e vështirë që normat e interesit të parashikohen ashtu siç mund të parashikohet koha. Meqenëse, normat e interesit reflektojnë aktivitetin njerëzor, një parashikim afatgjatë është pothuajse i pamundur. Megjithatë, luhatjet e tyre nuk janë krejt të rastësishme. Disa parashikime mund të bëhen duke mbajtur nën vëzhgim elementet e shumta, që diktojnë normat e interesit, disa prej të cilëve po i shpjegojmë më poshtë.
 - Kërkesa dhe oferta:** Ashtu siç ndodh me çdo çmim tjetër, edhe normat e interesit ndikohen nga forcat e kërkesës dhe ofertës, dhe në rastin tonë nga kërkesa dhe oferta për kredi. Në qoftë se oferta për kredi nga huadhënësit është më e lartë në krahasim me kërkesën e huamarrësve, çmimi (norma e interesit) do të bjerë, për shkak se huadhënësit konkurrojnë me njëri-tjetrin për të afruar sa më shumë klientë pranë vetes. Në rastet kur kërkesa është më e lartë se sa oferta, norma e interesit do të rritet për shkak se huamarrësit konkurrojnë për të marrë fonde që janë të pamjaftueshme për të

gjithë. Shumë prej nesh i ruajnë kursimet e tyre në institucione depozituese si banka, shoqëri kursimesh dhe unione krediti ose në institucione financiare, si kompani sigurimi. Dhe është pikërisht gatishmëria e njerëzve dhe e firmave për të mos shpenzuar, me fjalë të tjera kursimet, që përbëjnë burimin kryesor të ofertës për kredi. Nga ana tjetër, qëndrojnë ata të cilët me gjithë dëshirën e mirë për të shpenzuar apo për të investuar, nuk kanë mjetet e mjaftueshme financiare për ta bërë një gjë të tillë. Pra, burimi kryesor i kërkesës për kredi është dëshira jonë për të shpenzuar dhe mundësitë për të investuar. Po ku takohen kjo kërkesë dhe kjo ofertë? Ky “takim” mundësohet nga institucionet financiare si, bankat, unionet e kreditit etj., të cilat bëjnë lidhjen midis atyre që kursejnë dhe atyre që marrin hua. Këto institucione financiare, përdorin kursimet e depozituara pranë tyre, për t’u ofruar kredi njerëzve që duan të marrin hua, sigurisht kundrejt një interesi. Ky proces quhet ndërmjetësim financiar dhe është një prej proceseve më të rëndësishme që kryejnë institucionet financiare.

- ii. **Burimi i kërkesës: Konsumi.** Në një kohë apo në një tjetër, të gjithë konsumatorët, bizneset apo qeveritë kanë nevojë për kredi, për të blerë mallra ose shërbime. Në këto kushte, huamarrësit pranojnë t’i paguajnë interes huadhënësit, sepse u intereson t’i kenë mallrat dhe shërbimet menjëherë dhe jo të presin derisa të kenë kursyer një shumë parash që do t’u mundësojë blerjen. Për të përshkruar këtë dëshirë për të shpenzuar në moment, përdoret termi “normë e lartë e preferencës në kohë”. E shprehur më thjesht, kur një konsumator ka një normë të lartë të preferencës në kohë ai është i prirur të blejë mallra apo shërbime tani, dhe jo të presë për ta kryer këtë blerje në të ardhmen. Investimi. Në përdorimin e fondeve për investim, preferenca e kohës nuk është faktori kryesor. Në këtë rast, konsumatorët, bizneset dhe qeveritë marrin hua vetëm në qoftë se mendojnë që prej kësaj huaje do të nxjerrin një fitim. Kështu, ata marrin hua duke shpresuar që të krijojnë një mundësi fitimi prej saj. Për shembull, pronari i një fabrike sheh mundësinë për të blerë një makineri të re, e cila pritet t’i shtojë të ardhurat me 20 për qind. Pronari i fabrikës do të aplikojë për një kredi vetëm në qoftë se ajo mund të merret me një normë interesi më pak se 20 për qind. Ajo që huamarrësit janë të gatshëm të paguajnë, varet kryesisht nga preferenca e kohës për konsumin aktual dhe nga norma e pritshme e fitimit për një investim.
- iii. **Burimi i ofertës:** Oferta e kredisë varet nga kursimet – fonde të cilat nuk nevojiten për përdorim të menjëhershëm. Kur përmendim kursimet, shumica prej nesh kanë parasysh para të kursyera në një llogari kursimesh. Megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e kursimeve në total. Të gjitha fondet që nuk përdoren për të blerë mallra ose shërbime janë pjesë e totalit të kursimeve. Për shembull, kontributet për fondet e pensioneve, fonde të lëna mënjanë për të blerë aksione ose për t’u investuar në bono thesari, ose fonde të cilat kursehen nga llogaria rrjedhëse, të gjitha këto janë pjesë e totalit të kursimeve. Thamë që, niveli i përgjithshëm i normave të interesit përcaktohet nga bashkëveprimi ndërmjet kërkesës dhe ofertës. Kur këto të dyja takohen me njëra-tjetrën, ato përcaktojnë një çmim (çmimi i ekuilibrit), i cili ka tendencën të jetë relativisht i qëndrueshëm. Megjithatë, është vënë re se çmimi i kredisë nuk është domosdoshmërisht i qëndrueshëm, duke nënkuptuar që diçka e ndryshon kërkesën ose ofertën, ose të dyja bashkë. Le të shohim disa prej faktorëve që influencojnë këto ndryshime në ofertë dhe kërkesë.
- iv. **Inflacioni i pritshëm.** Normat e interesit përcaktojnë çmimin që duhet të paguajnë huamarrësit kur aplikojnë për një kredi. Huamarrësit dhe huadhënësit nuk shqetësohen për fondet aq sa shqetësohen për mallrat dhe shërbimet që mund të blejnë me këto fonde, ose e thënë ndryshe: për fuqinë blerëse të parasë. Inflacioni redukton fuqinë blerëse të parasë. Çdo rritje në pikë përqindjeje e inflacionit, nënkupton afërsisht 1 për qind rënie të sasisë së mallrave dhe shërbimeve që mund të blihen me një shumë të

caktuar parash. Si rezultat, huadhënësit, duke dashur të mbrojnë fuqinë blerëse, ia shtojnë normën e pritur të inflacionit normës së interesit që ata kërkojnë. Huamarrësit janë të gatshëm të paguajnë këtë normë më të lartë, sepse ata presin që inflacioni t'u japë atyre mundësinë ta shlyejnë borxhin me më pak para. Gjithashtu, çdokush që depoziton para apo i jep ato hua për një periudhë të caktuar kohe, kërkon të jetë i sigurt që kur t'i tërheqë nga banka apo kur t'i kthehet kredia, shuma të ketë të njëjtën vlerë. Meqenëse çmimet mund të rriten, atëherë për të ruajtur vlerën e kursimeve në kohë, këto pritje duhen patur parasysh dhe duhet të reflektohen në normën e interesit. Niveli i interesit duhet të jetë i tillë që të kompensojë rënien e vlerës së parasë ose të fuqisë blerëse, për shkak të ndryshimit të çmimeve.

v. **Kushtet ekonomike.** Kërkesa e konsumatorëve dhe e bizneseve për të marrë hua, ndikon në kërkesën për kredi. Kjo kërkesë ka tendencën të ndryshojë sipas kushteve të përgjithshme ekonomike. Kur aktiviteti ekonomik zhvillohet dhe perspektiva duket e favorshme, konsumatorët kërkojnë shuma të konsiderueshme kredish në mënyrë që të mundësojnë blerjen e një shtëpie, të një makine dhe në të njëjtën kohë, të rrisin konsumin aktual. Duke pasur këto qëllime pozitive, ata presin të kenë të ardhura më të mëdha dhe si rezultat i kësaj, janë më të gatshëm për të ndërmarrë përgjegjësi në të ardhmen. Bizneset bëhen gjithashtu më optimiste dhe kërkojnë fonde për të financuar zgjerimin e aktivitetit dhe blerjen e pajisjeve të ndryshme, që nevojiten për të furnizuar rritjen e kërkesës. Kështu, situata e mësipërme mund të çojë në një tepëri kërkesë për fonde, duke ushtruar presione për rritjen e normës së interesit të huamarrjes. Nga ana tjetër, kur shitjet janë të ulëta dhe e ardhmja duket e zymtë, konsumatorët dhe bizneset kanë tendencën të reduktojnë blerjet e tyre të mëdha, ndërsa huadhënësit, të shqetësuar për aftësitë e huamarrësve për të paguar borxhin e marrë, ngurrojnë të japin hua. Si rezultat, kërkesa dhe oferta për kredi mund të ulet, duke ndikuar dhe nivelin e normës së interesit. Në qoftë se kërkesa dhe oferta lëvizin në të njëjtën masë atëherë normat e interesit mund të mos lëvizin.

vi. **Politika Monetare.** Në përgjithësi, normat e interesit përcaktohen nga tregu, megjithatë ndërhyrja e bankës qendrore mund të ndikojë në luhatjet e normave të interesit. Politika monetare prek treguesit ekonomikë me anë të ndryshimit të normave afatshkurtra të interesit. Ajo synon administrimin e kushteve monetare të ekonomisë – ofertës monetare, normave të interesit dhe kursit të këmbimit – në funksion të realizimit të objektivit apo të objektivave kryesorë, që mund të ketë një bankë qendrore. Për të administruar ekonominë e vendit, autoriteti monetar ndërhyr në tregjet financiare, duke ndryshuar ofertën e parasë. Kur thuhet se një autoritet monetar e ka lehtësuar politikën monetare, kjo do të thotë se ky autoritet ka rritur ofertën monetare në ekonomi ose e thënë më thjesht, banka qendrore ka krijuar para të tjera nëpërmjet printimit dhe i ka hedhur ato në qarkullim. Ky veprim i ul normat e interesit, sepse ka më tepër para në qarkullim si për huamarrësit, ashtu edhe për huadhënësit. Në qoftë se oferta e parasë zvogëlohet, kjo shkakton rritjen e normave të interesit.

4. **Nivele dhe lloje të ndryshme rreziku:** Përveç faktorëve të mësipërm ka dhe disa faktorë të tjerë më specifikë, që ndikojnë në përcaktimin e normave të interesit. Disa prej këtyre faktorëve lidhen me nivelet dhe llojet e ndryshme të rrezikut. Fjala “rrezik” nënkupton rastet kur diçka e padëshirueshme mund të ndodhë. Në qoftë se shkoni diku për ski, ju duhet të merrni parasysh një sërë rreziqesh. Në të njëjtën mënyrë duhet të merren parasysh edhe rreziqet financiare. Nivelet e rrezikut që njerëzit janë të gatshëm të pranojnë ndryshojnë tek çdo njeri. Disa njerëz nuk shkojnë kurrsesi për ski, ndërsa të tjerë shkojnë pa e menduar dy herë. Kështu ndodh edhe me transaksionet e kredive, disa njerëz pranojnë nivele të ndryshme rreziku. Megjithatë, ata pranojnë të rrisin nivelin e rrezikut vetëm në qoftë se marrin një kompensim më të lartë për investimet e kryera. Edhe pse, huadhënësit janë të gatshëm të pranojnë nivele të ndryshme

rreziqesh, ata kërkojnë të kompensohen për këtë rrezik të ndërmarrë. Prandaj, meqenëse nivelet e rrezikut ndryshojnë, edhe normat e interesit kanë tendencën të ndryshojnë. Zakonisht, normat e interesit ndikohen nga tre lloje rreziqesh:

- a. **Rreziku i mospagimit brenda afatit:** Ndodh që edhe huamarrësit më korrektë të mos jenë në gjendje të paguajnë borxhin e tyre për një sërë arsyesh. Në qoftë se huamarrësit nuk i kryejnë pagesat e tyre në kohë, interesi që marrin huadhënësit reduktohet; kur huamarrësit nuk paguajnë një pjesë të principalit të tyre, interesi i huamarrësve është negativ. Të gjitha huatë mund të preken nga rreziku i moskryerjes në kohë të pagesave ose të përballen me probleme, të cilat pengojnë kryerjen e pagesave. Huadhënësit preferojnë që ta reduktojnë rrezikun kur japin hua. Si rezultat, shumë prej huadhënësve janë të detyruar t'i sigurojnë huatë e tyre; çka do të thotë që huamarrësit i japin huadhënësit një lloj garancie kundrejt rrezikut të mospagimit të kësteve të huasë. Shpeshherë, kjo garanci vjen në formën e një kolaterali, një objekt fizik që është në pronësinë e huamarrësit dhe të cilin ai mund ta shesë, në qoftë se nuk është në gjendje të paguajë huanë e marrë. Për shembull, për kreditë për automjet, vetë automjeti shërben si kolateral për kredinë. Në përgjithësi, kreditë e siguruara janë më pak të rrezikuara, prandaj ato kanë edhe interesat më të ulët në treg.
 - b. **Rreziku i likuiditetit:** Përkrah rrezikut të mospagimit qëndron edhe rreziku i likuiditetit, i cili ndikon normat e interesit. Në qoftë se një letër me vlerë shitet për afërsisht me të njëjtin çmim që është blerë, ajo konsiderohet me likuiditet të lartë. Kjo do të thotë që ajo mund të shndërrohet në para shumë më lehtë se sa një letër me vlerë, e cila nuk shitet për afërsisht me çmimin e blerjes. Rrjedhimisht, është më pak e rrezikshme se sa një letër me vlerë, e cila ka një diferencë të madhe midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes.
 - c. **Rreziku i maturitetit:** Transaksionet e kredive në përgjithësi përfshijnë dhënien dhe marrjen e fondeve, për një periudhë të caktuar kohe. Në përfundim të kësaj kohe, huaja konsiderohet e maturuar dhe duhet të paguhet. Kohëzgjatja e maturitetit është një tjetër burim i rrezikut të maturitetit. Letrat me vlerë afatgjata janë më tepër të rrezikuara se sa ato afatshkurtra, sepse e ardhmja është e pasigurt dhe mundësia që të shfaqen probleme është më e madhe kur kohëzgjatja e maturitetit është e lartë. Ky rrezik zakonisht shkakton rritjen e normave të interesit për letrat me vlerë afatgjata.
5. **Shpërndarje e barabartë.** Duke patur një shumëllojshmëri të normave të interesit dhe disa faktorë që kanë ndikim mbi to, mund të duket sikur huamarrja dhe huadhënia është një proces i komplikuar dhe pa ndonjë efekt të dukshëm. Në fakt, shumëllojshmëria e normave të interesit reflekton efikasitetin e tregut në shpërndarjen e fondeve. Huadhënësit kërkojnë një interes të lartë që të jetë i mjaftueshëm për të kompensuar të gjitha rreziqet që diskutuam më sipër. Ndërsa, përsa i përket huamarrësve, ata do të ndërmarrin vetëm projekte, të cilat do të sjellin të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar të paktën kostot e huamarrjes. Përsa i përket tregut, ai shërben për të siguruar që vetëm projektet që e meritojnë të financohen, do të marrin një hua. Me fjalë të tjera, forcat dhe ndryshimet e tregut bashkëpunojnë për të mbështetur shpërndarjen efikase të fondeve.
6. **Ndikimi i normave të interesit në ekonomi:** Kur normat e interesit ulen, huamarrja bëhet më atraktive/joshëse. Kur në tregun bankar ekzistojnë norma të ulëta interesi, konsumatorët e kanë më të lehtë të blejnë një makinë apo një shtëpi. Blerja e një shtëpie, rrit kërkesën për mallra të tjerë si mobilje, pajisje elektrike, duke i dhënë kështu një shtysë rritjes ekonomike. Për më tepër, konsumatorët shpenzojnë më pak në kostot e interesit, duke u dhënë mundësi atyre të kenë më shumë para për të shpenzuar në mallra dhe shërbime. Gjithashtu, kur normat e interesit janë të ulëta, fermerët, prodhuesit dhe bizneset e tjera e kanë më të lehtë të marrin hua për të investuar në blerjen e makinerive të ndryshme dhe në ndërtimin e ambienteve të reja. Për më tepër, fitimet që këto biznese sjellin në të ardhmen janë më të vlefshme kur normat e interesit janë të ulëta se sa kur ato janë të larta. Kjo u jep shtytje bizneseve të investojnë, në një kohë kur normat e interesit janë të ulëta. Për rrjedhojë, rritja e investimeve

i jep zhvillim më të lartë ekonomisë. A do të thotë kjo se një ekonomi që të zhvillohet duhet të ketë norma sa më të ulëta interesi? Përgjigjja varet se sa të ulëta janë normat e interesit. Në periudha normale, autoriteti monetar (zakonisht një bankë qendrore) mund të nxisë ekonominë, duke ulur normat e interesit ose duke rritur bazën monetare. Secili nga veprimet ndikon në rritjen e huamarrjes, të konsumit dhe të investimeve fikse. Por, në qoftë se normat e interesit janë shumë të ulëta dhe afër zeros, atëherë banka qendrore nuk mund t'i ulë më tej ato për të stimuluar ekonominë. Në një situatë të tillë, me norma interesi kaq të ulëta, askush nuk është i gatshëm të japë hua. Ndryshimet në normat e interesit mund të ndikojnë dhe kursin e këmbimit të një monedhe. Për shembull, një normë më e lartë e interesit në lekë krahasuar me interesat në valutë i bën investimet në lekë më joshëse, pasi kthimi nga ky investim është më i lartë. Kjo bën që të rritet vlera e lekut kundrejt këtyre monedhave. Normat e larta të interesave kanë dy lloj efektsh kontradiktore mbi kursimet e konsumatorëve. Së pari, sa më tepër të fitojnë njerëzit nëpërmjet kursimeve, aq më të prirur janë ata për të kursyer. Megjithatë, sa më të mëdha të jenë fitimet, aq më të pasur ndihen kursimtarët, rrjedhimisht ata do të shpenzojnë më tepër në vend që të kursejnë.

7. **Normat kryesore të interesit në sistemin bankar shqiptar:** Norma bazë e interesit Norma bazë e interesit, e njohur ndryshe edhe si çmimi i mbajtjes së parasë, është norma e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë për të mbajtur inflacionin brenda kufijve të synuar. Kjo normë luan rolin e instrumentit kryesor, të përdorur për të përcjurar sinjalet e politikës monetare në ekonomi. Norma bazë e interesit aplikohet nga Banka e Shqipërisë në ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes (repo) dhe në marrëveshjet e anasjellta të riblerjes (repo-t e anasjellta). Aktualisht, norma bazë e interesit në vendin tonë është 5.50 për qind. Repo-t dhe repo-t e anasjellta janë instrumente të përdorura nga Banka e Shqipërisë për të administruar likuiditetin e sistemit bankar. Marrëveshjet e riblerjes janë operacionet e tregut të hapur, gjatë të cilave Banka e Shqipërisë u shet letra me vlerë bankave të nivelit të dytë dhe i riblen ato në një datë të mëvonshme, të vendosur sipas kushteve të paracaktuara. Ndërsa marrëveshjet e anasjellta të riblerjes janë operacione të tregut të hapur, gjatë të cilave Banka e Shqipërisë blen letra me vlerë dhe i rishet në datën e caktuar, sipas termave të kontratës. Norma bazë e interesit shërben si orientuese për nivelin e normave të interesit në ekonomi. Kjo normë përcakton edhe normën e interesit të depozitave dhe të huave njëditore të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, ajo ndikon normën e interesit të tregut ndërbankar, të depozitave në lekë pranë bankave tregtare si dhe të bonove të thesarit, dhe të kredisë së akorduar në lekë për ekonominë. Norma e interesit të bonove të thesarit ose yield-i Bonot e thesarit dhe obligacionet janë instrumente borxhi, nëpërmjet të cilave Qeveria merr hua nga publiku dhe siguron të ardhurat e nevojshme, për të financuar borxhin e saj të brendshëm. Huamarrja nga publiku ndryshe do të kuptohej si shitja e letrave me vlerë të qeverisë, publikut. Aktualisht, Qeveria Shqiptare emeton dy lloje letrash me vlerë: bono thesari dhe obligacione. Bonot e thesarit tregtohen për periudha 3, 6 dhe 12-mujore, ndërsa obligacionet kanë periudha maturimi më të gjata, 2, 3 dhe 5-vjeçare. Si për çdo borxh të kërkuar, për të cilin paguhen interesa edhe qeveria paguan interesa për këtë borxh. Por, ajo kërkon që këta interesa të jenë sa më të ulët. Për këtë arsye, ajo ka zgjedhur si mënyrë shitjeje ankandin. Subjektet e ndryshme që duan të marrin pjesë në ankand, përcaktojnë në kërkesën e tyre jo vetëm shumën që duan të investojnë, por edhe yield-in në përqindje. Kjo procedurë ndiqet në rastin e kërkesave konkurruese, por ekziston edhe mundësia e kërkesave jokonkurruese, yield-i i të cilave përcaktohet nga përqindja mesatare e ponderuar e yield-it, që rezulton nga kërkesat konkurruese, të paraqitura dhe të pranuar. Ministria e Financave në bazë të nivelit të yield-it, përcakton edhe fituesit. Përzgjedhja bëhet duke filluar nga niveli më i ulët i yield-it deri në plotësimin e shumave përkatëse. Niveli i yield-it përcaktohet në mënyrë të tërthortë nga niveli mesatar i kërkesave konkurruese. Kjo tregon njëkohësisht edhe sinjalet e tregut për çmimin e letrave me vlerë, duke e bërë procesin më pasqyrues të realitetit. Përcaktimi i yield-it ndjek një logjikë e cila bazohet në studimin e tregut, megjithatë ndikohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe nga norma bazë e interesit. Bankat nuk do të pranonin të investonin në

bono thesari nëse ato do të kishin norma më të ulta interesi se norma bazë. Pra norma bazë shërben si një normë reference, që banka qendrore e përshtat me kushtet makroekonomike të vendit, ndërkohë që vetë yield-i ndikohet edhe nga faktorë të tjerë si përputhshmëria e kërkesës dhe ofertës për këtë instrument.

8. **Norma e interesit të kredive:** Norma e interesit të kredive të ofruara nga bankat, është një pikë kryesore pas të cilës rendin jo vetëm bankat, sepse prej tyre varen të ardhurat e aktivitetit bankar, por edhe klientët, pasi për ta është mëse e domosdoshme të njohin koston e kredisë së marrë pranë bankës. Shuma e interesave për t'u paguar varet nga disa faktorë:
- a. shuma kryesore e marrë ose e dhënë hua,
 - b. kohëzgjatja për të cilën është marrë/dhënë huaja,
 - c. norma e deklaruar vjetore e interesit,
 - d. grafiku i shlyerjes së kredisë dhe mënyra e përlogaritjes së interesit.

Në tregun bankar shqiptar, normat e interesit të kredive të ofruara prej bankave, ndryshojnë edhe në varësi të monedhës me të cilën shprehet kredia. Bankat shqiptare japin kredi në euro, në dollarë amerikanë dhe në lekë. Norma e interesit në valutë të huaj, euro dhe dollar, është në varësi të normave bazë ndërkombëtare, përkatësisht të euribor-it (E) dhe libor-it (L), plus një normë në përqindjeje, të vendosur nga vetë bankat. Euribor dhe libor janë normat bazë të vendosura prej Bankës Qendrore Evropiane dhe Rezerva Federale. Ndryshimi i këtyre normave ndërkombëtare, për dy monedhat kryesore ndërkombëtare, çon dhe në ndryshimin e masës së koston të paguar prej klientit kredimarrës. Në përgjithësi, klientët individë preferojnë të marrin kredi në lekë, pasi dhe kredia konsumatore në shumicën e bankave shqiptare jepet në lekë. Për kredinë në lekë, bankat shpesh kanë si normë reference yieldin e bonove të thesarit (BTH), kryesisht atë me maturim 12-mujor. Për shembull, një normë kredie në lekë për shtëpi, nga një bankë e caktuar mund të shprehet si bono thesari +5 për qind. Klientët, biznese apo korporata, duke kryer transaksione të konsiderueshme në monedhë të huaj, preferojnë që kredia e marrë prej tyre të shprehet në valutë.

Një tjetër arsye që ndikon në normën e interesit të kredisë është edhe qëllimi i marrjes të kredisë. Në varësi të llojeve të ndryshme të kredive (konsumatore, hipotekare, për aktivitet tregtar etj.) ndryshon edhe norma e interesit që kërkon banka. Kështu për shembull, një kredi e akorduar për aktivitet tregtar është më e shtrenjtë se një kredi për blerjen e një pasurie të paluajtshme.

9. **Norma e interesit të depozitave:** Norma e interesit të depozitave është një ndër elementet kryesore që përdor një bankë tregtare për të tërhequr klientë drejt saj. Në qoftë se një bankë ofron interesa të lartë për depozitimet, të shoqëruar me një nivel të lartë sigurie dhe cilësie në shërbim, atëherë klientët janë të siguruar. Mirëpo, normat e interesit të depozitave përbëjnë kosto për bankat tregtare. Në tregun tonë bankar, bankat pranojnë depozitime për maturitete dhe monedha të ndryshme. Në përgjithësi, normat e interesit si në lekë ashtu dhe në valutë, varen nga politikat vetjake të bankave tregtare, si ruajtja e konkurrencës në tregun bankar, të qenurit agresive për të fituar pjesë në këtë treg, tërheqja drejt tyre e një monedhe të caktuar etj.. Normat e interesit për depozitimet në valutë, varen kryesisht nga politikat monetare të bankave qendrore të monedhave përkatëse. Për shembull, normat e depozitave në euro dhe në dollarë varen nga ecuria e normave të interesit në këto monedha, të përcaktuara nga Banka Qendrore Evropiane dhe FED. Përsa i përket normave të interesit të depozitave në lekë, ato përshtaten në varësi të sinjaleve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë apo dhe ecurisë së yield-it të bonove të thesarit.

Siç shihet, normat e interesit janë të shumta dhe të larmishme dhe variojnë në përputhje me një grup faktorësh dhe rrethanash të caktuara. Këtu nuk marrim përsipër të japim një kuadër të plotë të llojeve të ndryshme të normave të interesit apo të mënyrave se si ato përcaktohen. Megjithatë, po japim disa njohuri bazë, të nevojshme për tju ndihmuar të orientoheni më lehtë

në botën e komplikuar të tregjeve financiare si dhe për të interpretuar pasojat që sjellin ndryshimet e këtyre normave, në financat tona personale.

Norma efektive e interesit

Siç jeni në dijeni, në Raportin përfundimtar të Bankës së Shqipërisë, dërguar pranë Fondit BESA sh.a. në pikën 26 të raportit përcaktohet që “Fondi BESA sh.a. duhet të hartojë metodologjinë e llogaritjes së normave të interesit për kreditë në përputhje me kërkesat rregullatore.”

- Së pari, **norma vjetore e interesit efektiv** quhet gjithashtu **normë efektive interesi**, ose **norma vjetore ekuivalente (NVE)**, dhe është e ndryshme nga **(NVP) – norma vjetore e përqindjes**.
- Ne fakt, norma vjetore e interesit efektiv është me e larte se norma vjetore e përqindjes.

Duke gjykuar mbi këtë kërkesë të Bankës së Shqipërisë, më poshtë po saktësojmë ato elemente të cilët do të përfshihen në kontratën e Kredisë dhe konkretisht:

1. Mënyrën e përllogaritjes së Normës Efektive të Interesit (NEI) duke e përshtatur në mënyrë “ekzakte” me metodën e përcaktuar ne Rregulloren Nr. 59, datë 29.08.2008 “**MBI TRANSPARENCËN PËR PRODUKTET DHE SHËRBIMET BANKARE E FINANCIARE**”.

Sipas kësaj Rregullore në Nenin 6 “Metoda e llogaritjes dhe publikimi i normës efektive të interesit për kreditë” në pikën 1 përcaktohet që në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje përcaktohet formula e përllogaritjes së NEI.

Për rastin e kredive, të cilat disbursohen me një pagesë të vetme (jo linja kredie) formula e përllogaritjes së NEI do të ishte:

$$P = \sum_{j=1}^n \frac{K}{(1+I)^j}$$

ku:

- P:** Është vlera totale faktike e kredisë, duke zbritur çdo shpenzim të mbajtur për shembull, shpenzimet administrative. Pra =(Shumën e Miratuar të Kredisë – Fondin e Garancisë)
- J:** Numri i kësteve nga 1 deri në n (sa këste parashikohet të paguhet kredia)
- K:** Shuma e këstit mujor të kredisë
- I:** NEI

Shembull 1:

Në rastin e një kredie të miratuar me të dhëna si më poshtë:

Shuma:	100,000 lekë
Afati:	12 muaj
Interesi vjetor:	24%
Mënyra e pagesës:	E sheshtë (Kalendari PMT)
Fondi i Garancisë:	1%

NEI do të përllogaritet sipas kësaj formule:

$$99,000 = 9,455.96$$

$$P=100,000 - 100,000*1\% = 99,000 \text{ ALL}$$

$$J=12$$

$$K= 9,455.96 \text{ ALL}$$

$$I=NEI= 29.294\%$$

$$99,000 = \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{1}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{2}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{3}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{4}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{5}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{6}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{7}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{8}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{9}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{10}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{11}{12}}} + \frac{9,455.96}{(1 + 29.29\%)^{\frac{12}{12}}}$$

Shuma e Kredise	100,000			Shuma Totale	113,472			
Interesi	24.00%			Interesi Total	13,472			
Afati ne muaj	12							
Frekuenca	1				(31,205)			
Kësti Mujor	9,455.96							

Nr.	Kësti Mujor	Interesi	Principali	Shuma e Mbetur	Interesi Total	RAPORTI KEST/(1+NEI)	NEI		
1	9,455.96	2,000.00	7,455.96	100,000.00		9,255.66	29.294%		
2	9,455.96	1,850.88	7,605.08	92,544.04		9,059.60	29.294%		
3	9,455.96	1,698.78	7,757.18	84,938.96		8,867.70	29.294%		
4	9,455.96	1,543.64	7,912.32	77,181.78		8,679.86	29.294%		
5	9,455.96	1,385.39	8,070.57	69,269.46		8,496.00	29.294%		
6	9,455.96	1,223.98	8,231.98	61,198.89		8,316.04	29.294%		
7	9,455.96	1,059.34	8,396.62	52,966.90		8,139.88	29.294%		
8	9,455.96	891.41	8,564.55	44,570.28		7,967.46	29.294%		
9	9,455.96	720.11	8,735.85	36,005.73		7,798.69	29.294%		
10	9,455.96	545.40	8,910.56	27,269.88		7,633.50	29.294%		
11	9,455.96	367.19	9,088.77	18,359.32		7,471.80	29.294%		
12	9,455.96	185.4	9,270.5	9,270.5	13,471.52	7,313.53	29.294%	98,999.74	99,000

Shembull 1/1:

Në rastin e një kredie të miratuar me të dhënat e mëposhtme:

Shuma: 100,000 lekë;
 Afati: 12 muaj;
 Interesi vjetor: 24%;
 Mënyra e pagesës: E sheshtë (Kalendari PMT);
 Fondi i Garancisë: 0%,

NEI do të përlllogaritet sipas kësaj formule:

Për të njëjtat kushte mësipër në rastin kur fondi i Garancisë është 0%, NEI = 26.82%

Shuma e Kredisë	100,000			Shuma Totale	113,472			
Interesi	24.00%			Interesi Total	13,472		NEI:	26.8242%
Afati në muaj	12							
Frekuenca	1				(31,205)			
Kësti Mujor	9,455.96							

Nr.	Kësti Mujor	Interesi	Principali	Shuma e Mbetur	Interesi Total	RAPORTI KEST/(1+NEI)	NEI		
1	9,455.96	2,000.00	7,455.96	100,000.00		9,270.55	26.82%		
2	9,455.96	1,850.88	7,605.08	92,544.04		9,088.77	26.82%		
3	9,455.96	1,698.78	7,757.18	84,938.96		8,910.56	26.82%		
4	9,455.96	1,543.64	7,912.32	77,181.78		8,735.85	26.82%		
5	9,455.96	1,385.39	8,070.57	69,269.46		8,564.55	26.82%		
6	9,455.96	1,223.98	8,231.98	61,198.89		8,396.62	26.82%		
7	9,455.96	1,059.34	8,396.62	52,966.90		8,231.98	26.82%		
8	9,455.96	891.41	8,564.55	44,570.28		8,070.57	26.82%		
9	9,455.96	720.11	8,735.85	36,005.73		7,912.32	26.82%		
10	9,455.96	545.40	8,910.56	27,269.88		7,757.18	26.82%		
11	9,455.96	367.19	9,088.77	18,359.32		7,605.08	26.82%		
12	9,455.96	185.4	9,270.5	9,270.5	13,471.52	7,455.96	26.82%	100,000.00	100,000

Shembull 2:

Në rastin e një kredie të miratuar me të dhënat e mëposhtme:

Shuma: 100,000 lekë
 Afati: 12 muaj
 Interesi vjetor: 24%
 Mënyra e pagesës: E sheshtë (Kalendari PMT)
 Fondi i Garancisë: 2%

NEI do të përlogaritej sipas kësaj formule:

$$P=100,000 - 100,000*2\% = 98,000 \text{ ALL}$$

$$J=12$$

$$K= 9,455.96 \text{ ALL}$$

$$l=29.523 \text{ në vit}$$

$$98,000 = \frac{5,287}{(1 + 29.52\%)^{\frac{1}{12}}} + \dots \dots \dots \frac{5,287}{(1 + 29.52\%)^{\frac{24}{12}}}$$

Mbi sa më sipër do të duhet të ripërcaktohet nëse Fondi i Garancisë do të zbritet nga Principali i Kredisë, pasi kjo do të ndikonte ndjeshëm në NEI që do të publikohej në kontratën e Kredisë.

Për ta ilustruar po marrim shembullin më poshtë:

SHUMA	200,000	500,000	1,000,000
INTERSI VJETOR (KREDI ME HIPOTEKE)	27%	26.20%	24%
AFATI (MUAJ) Fee 1%	12	12	12
AFATI (MUAJ) Fee 2%	24	24	24
AFATI (MUAJ) Fee 3%	36	36	36
NEI (Kredia 12 Muaj)	33.160%	32.118%	29.2932%
NEI (Kredia 24 Muaj)	33.413%	32.365%	29.5230%
NEI (Kredia 36 Muaj)	33.618%	32.563%	29.7100%

SHUMA	21,000 Euro
INTERSI VJETOR (Euro)	18%
AFATI (MUAJ) Fee 1%	12
AFATI (MUAJ) Fee 2%	24
AFATI (MUAJ) Fee 4%	96
NEI (Kredia 12 Muaj)	21.86%
NEI (Kredia 24 Muaj)	22.05%
NEI (Kredia 96 Muaj)	21.18%

- Lidhur me Metodën e Llogaritjes së këstit të Kredisë mendojmë se ajo duhet të saktësohet për të tre llojet e pagesave (kalendarëve të pagesave) që aplikon Fondi BESA sh.a. respektivisht “Kalendarit me Pagesë Fikse”; “Kalendarit me Pagesë zbritëse” dhe Kalendarit i Kredisë “BESA-AGRO”.*

Mbi sa më sipër mendoj të përcaktohet në kantatë si më poshtë:

Në rastin e kalendarit me pagesë fikse:

Kësti i Kredisë (Principal + Interes) = Formula Algjebrike PMT (Interesi mujor i kredisë, afati i Kredisë në muaj - Shumën e Miratuar të Kredisë).

Shembull:

Shuma e miratuar e kredisë: 100 ALL
 Interesi Vjetor: 24%
 Interesi mujor: 2%

Afati i kredisë: 1 vit (12 muaj)

Kësti i Kredisë (Interes + Principal) = $PMT(2\%,12,-1000)=9.46$ ALL

Në rastin e kalendarit me pagesë zbritëse (declining)

Kësti i kredisë (Principal + Interes) = Principal mujor (Shuma e Kredisë së Miratuar)/Afati i kredisë në muaj + Interesi mujor *(outstanding pjesën e papaguar të kryegjësë).

Shembull:

Shuma e miratuar e kredisë: 100 ALL
Interesi Vjetor: 24%
Interesi mujor: 2%
Afati i kredisë: 1 vit (12 muaj)

Kësti i Kredisë pagesa Muaji I (Interes + Principal) = $100/12 + 2\%*100 = 8.33 + 2 = 10.33$

Kësti i Kredisë pagesa Muaji II (Interes + Principal) = $100/12 + 2\%*(100 - 8.33) = 10.17$

Në rastin e kalendarit të Kredise BESA-AGRO

Kësti i Kredisë (Principal + Interes) = Përqindjen Mujore të Pagesës * Këstin Vjetor të Kredisë (Principal + Interes).

Interesi vjetor i Kredisë = Përqindjen Vjetore të Interesit të Kredisë * Outstanding i kredisë në fillim të vitit respektiv).

Shembull:

Shuma e miratuar e kredisë: 100,000 Lekë
Interesi Vjetor i kredisë: 16.28%
Afati i Kredisë: 1 Vit
Pagesat e Kredisë: mujore në përqindje sipas negociatës me klientin
Shuma vjetore e Interesit: $16.277\% * 100,000 \text{ ALL} = 16,277 \text{ ALL}$


Kësti vjetor i Kredisë = (Principal + Interes) = $100,000 + 16,280 = 116,280$

Raporti në përqindje për çdo këst kredie (Principali $86\% 100,000/116,277$) - (Interesi $14\% 16,277/116,277$)

Gjithashtu mendojmë që në Anex-1 “Kalendari i Shlyerjeve në fund të tabelës të përcaktohet Totali i pagesës së Kësteve dhe Interesit.

Përdorimi i Formulës se NEI në “EXCEL”


Supozojmë se ju dëshironi të gjeni normën efektive të interesit nga një interes nominal 12% të një kredie me përllogaritje mujore. Ju keni të instaluar një faqe “Exceli” si më poshtë.




Vini re se ne kemi një interes nominal në qelizën **B1** si dhe numrin e periudhës së pagesave në qelizën **B2**.

Për të gjetur normën e interesit efektiv, klikoni në qelizën **B3**, klikoni te butoni “Insert Function”, dhe zgjidhni “Financial” nga menuja or “Select a Category”.

Zgjidhni funksionin “EFFECT” dhe klikoni butonin “OK”



Hapet faqja “**Functions Argument**”. Në kutinë e “**Interesit Nominal**”, klikoni te “**B1**” dhe “**Npery** , **B2**. Pastaj butonin **OK**



Na del shifra **0.1268** në qelizën **B3**. Nëse preferoni mund ta ktheni **B3** në përqindje 12.68%

The screenshot shows an Excel spreadsheet with the following data:

	A	B	C
1	Nominal Interest Rate (APR)	12%	
2	Periods in a Year	12	
3	Effective Interest Rate (APY)	12.68%	
4			
5			
6			
7			
8			

Shikoni sesi ndryshojnë vlerat në dy qelizat **B1** dhe **B2** dhe Exceli do të llogarisë Normën e Interesit Efektiv në qelizën **B3**.

P.sh., ndryshimi i Interesit Nominal në **B1** në **6%** dhe Norma e Interesit Efektiv në **B3** ndryshohet në **6.17%**. Duke përdorur **EFFECT** në Excel, ju mund të gjeni çdo Normë Interesi Efektiv të dhënë në Interesin Nominal dhe të bëni përlllogaritjet.